



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera -  
Ministry of Finance, Labour and Transfers*



***Dogana e Kosovës – Carina Kosova – Kosovo Customs***

Duke u bazuar në Kodin Doganor dhe të Akcizave në Kosovë Nr. 03/L-109, Udhëzimin Administrativ Nr. 37/2016 për Rregullimin e Marrëdhënies së Punës së Oficerëve Doganor, i plotësuar dhe ndryshuar me Udhëzimin Administrativ Nr. 60/2019, Udhëzimin Administrativ Nr.77/2022 dhe Udhëzimin Administrativ Nr.82/2024, Dogana e Kosovës shpall:

**KONKURS**

Për pranimin e oficerëve doganor, sipas kushteve të parapara të konkurrimit:

**Titulli i vendit të punës:** Oficer doganor

**Numri i pozitave të lira:** 115

**Klasa:** N7; **Koeficienti:** 6.5

**Periudha e kontratës:** kontratë fillestare 3-vjeçare përfshirë edhe periudhën provuese 6-mujore, me mundësi vazhdimi me kontratë të përhershme.

**Vendi:** Sipas kërkesave të Doganës në gjithë territorin doganor të Republikës së Kosovës.

**Orari i punës:** Sipas përcaktimeve për vendin e punës zbatohet orari i plotë i punës, duke përfshirë ndërrimin e natës, fundjavës, festave zyrtare dhe punën jashtë orarit të rregullt nëse është e nevojshme.

**Përshkrimi i përgjithshëm i punës**

Oficerët doganor ushtrojnë kontrollin e mallrave, udhëtarëve, mjeteve, aeroplanëve, mbrojnë Kosovën nga kërcënimet e terrorizimit, kontrabandës, mashtrimit, krimin të organizuar dhe parandalojnë hyrjen e paligjshme të narkotikëve dhe mallrave të falsifikuara, duke zbatuar drejt udhëzimet ligjore dhe procedurat e parapara doganore, për të arritur misionin dhe objektivat e përcaktuara nga Dogana e Kosovës.

Dogana e Kosovës funksionon 24 orë në ditë, 365 ditë në vit. Oficerët doganor punojnë me orare të ndryshme, duke përfshirë ndërrimin e natës, fundjavën, festat zyrtare dhe punën jashtë orarit, nëse është e nevojshme, në çdo vend në gjithë Kosovën.



### **Përshkrimi i detyrave të punës:**

- Kryen aktivitete operative nga fushëveprimi doganor si inspektime dhe ekzaminime të hollësishme të mallrave, mjeteve dhe individëve në kufi dhe brendi të vendit;
- Kryen funksione të ndryshme të zbatimit të ligjit, duke përfshirë inteligjencën, hetimet administrative dhe penale, mbledhje të informacioneve dhe provave;
- Zbaton procedura administrative për të siguruar mbledhjen e detyrimeve dhe aplikimin e masave të politikës tregtare të Republikës së Kosovës;
- Kryen patrullime të rregullta në zonat kufitare, vendkalime kufitare dhe aeroport, për të monitoruar dhe identifikuar rreziqe potenciale;
- Ndërmerr veprime të tjera për të përkrahur zbatimin e drejtë të ligjit me përdorimin e pajisjeve që bazohen në teknologji të ndryshme veprimi relevante për punën e Doganës së Kosovës;
- Siguron përkrahje ndaj komunitetit tregtar, duke garantuar përmbushjen e kërkesave doganore, lehtësuar rrjedhat e tregtisë legjitime për të mbështetur rritjen ekonomike të vendit;
- Komunikon me publikun e gjerë, importuesit, eksportuesit dhe palë e tjera të interesuara, duke ofruar ndihmë për të siguruar shërbime efikase nga fushëveprimi i Doganës;
- Kryen detyra të tjera të parapara me përshkrimin e punës si dhe detyra të deleguara nga mbikëqyrësi konform dispozitave të KDAK-së.



### **Njohuritë dhe aftësitë:**

- Aftësi dhe gatishmëri për të përvetësuar shpejt njohuri dhe për të kryer funksione të ndryshme doganore veçanërisht në lidhje me mallrat, mjetet e transportit dhe individët;
- Aftësi të mira komunikuese dhe njohje e gjuhëve zyrtare në vend, preferohet njohja e gjuhës angleze;
- Aftësi të mira të përdorimit të kompjuterëve dhe programeve bazike;
- Aftësi, shkathtësi profesionale të pozitës si dhe gatishmëri të punojë me ndërrime, sipas nevojave të Doganës në gjithë territorin e vendit;
- Aftësi për të punuar nën presion, të paraqesë besueshmëri dhe integritet të lartë personal;
- Aftësi për të analizuar informacionin, zgjidhur probleme dhe të vendimmarrjes;
- Të jetë anëtar efektiv i ekipit, duke u ofruar mbështetje të tjerëve për të arritur rezultate.



### **Kriteret e aplikimit:**

Për pozitën oficer doganor ka të drejtë të konkurrojë çdo person i cili i plotëson kriteret, si më poshtë:

1. Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
3. Të jetë i moshës tetëmbëdhjetë (18) deri tridhjetë (30) vjeç;
4. Të jetë në gjendje të mirë shëndetësore dhe i aftë fizikisht për t'i kryer detyrat e dhëna;
5. Të ketë diplomë universitare të kualifikimit bachelor ose kualifikim të barasvlershëm-preferohet në drejtësi, ekonomi, kimi, farmaci, biologji, teknologji dhe doganë.
6. Të japë informacionin e kërkuar në lidhje me punën e tij të mëparshme ose ndonjë çështje tjetër që lidhet me pranimin e tij në Doganë;
7. Dëshmi nga organet kompetente (Gjykata) se personi nuk është i dënuar ose ndaj saj/tij nuk është duke u zhvilluar procedurë penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare;
8. Të ketë reputacion të lartë profesional dhe integritet personal



### **Procedura, afatet dhe kushtet e pjesëmarrjes në këtë proces rekrutimi:**

**Në fazën e parë** do të bëhet përzgjedhja në bazë të dokumenteve të paraqitura dhe aplikacioneve, njoftimi i kandidatëve të diskualifikuar si dhe atyre të cilët do t'i nënshtrohen procedurave tjera të testimit.

#### **Në fazën e dytë, procedurat e testimit**

Procedura e testimit zhvillohet si në vijim:

- a. Testi me shkrim dhe
- b. Intervista me gojë.

Dogana e Kosovës gëzon të drejtën ligjore për prerjen e listës së kandidatëve dhe krijimin e listës më të ngushtë që do t'i nënshtrohen testit me shkrim dhe intervistës me gojë, duke u bazuar në lartësinë e pikëve të marra nga procesi i vlerësimit të aplikacioneve dhe testit me shkrim, në rastet kur numri i aplikantëve që kanë përmbushur kërkesat e konkursit, respektivisht kanë kaluar pragun e kalueshmërisë nga procesi i vlerësimit të aplikacioneve dhe testit me shkrim, është më i lartë se dhjetë (10) kandidatë të përshtatshëm për një pozitë të lirë.

Njoftimi i kandidatëve për orarin, vendin dhe procedurat e testimit do të bëhet së paku dhjetë (10) ditë kalendarike para datës së testit me shkrim, respektivisht intervistës me gojë.

Njoftimi i kandidatëve lidhur me procedurat e testimit do të publikohet në ueb faqen zyrtare të Doganës së Kosovës: <https://dogana.rks-gov.net>.

Kandidatëve të suksesshëm do t'iu ofrohet kontratë pune si kadet doganor në Doganën e Kosovës gjatë trajnimit bazik dhe praktik (operativ). Pas përfundimit me sukses të trajnimit bazik dhe praktik, i lëshohet kontratë pune trevjeçare e cila përfshin periudhën provuese gjashtëmuajore në pozitën e oficerit/asistentit doganor. Koeficientet e pagës do të jenë sipas legjislacionit në fuqi.

### **Afati i konkurrimit**

Konkursi i rekrutimit për oficerë doganor do të jetë i hapur prej **07.03.2024** deri më **22.03.2024**.

### **Mënyra e aplikimit**

Aplikimi për oficer doganor bëhet online. Kandidatët e interesuar mund të aplikojnë përmes ueb faqes së Doganës së Kosovës: <https://dogana.rks-gov.net>, menyja “**Mundësi punësimi**”, në vegëzën <http://e-aplikimi.dogana-rks.org/>

*Shënim: Dogana e Kosovës ka përgatitur edhe një udhëzues të detajuar për aplikim. Ju lutem t'i referoheni udhëzuesit.*

### **Në aplikacion duhet bashkëngjitur dokumentet e kërkuara si në vijim:**

1. Fotokopje të letërnjoftimit ose pasaportës;
2. Kopje të diplomës universitare dhe përgatitjeve tjera profesionale të kandidatit, ndërsa kandidatët që kanë përfunduar shkollimin jashtë vendit kopja e diplomës e nostrifikuar;
3. Vërtetimi nga gjykata që nuk është i dënuar dhe që nuk është nën hetime të jenë të vlefshme dhe të nxirren pas datës së shpalljes së konkursit.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk prahen, kurse aplikacionet e pakompletuara do të refuzohen.

Për informata shtesë mund të kontaktoni në tel: 038/ 540-807.

*Dogana e Kosovës me qëllim të afirmimit të barazisë gjinore, inkurajon dhe mirëpret aplikimin e pjesëtarëve të gjinisë të nën-përfaqësuar, për të vënë në shërbim potencialet e tyre individuale në funksion të zhvillimit institucional dhe shoqëror, dhe gjithashtu inkurajon të aplikojnë të gjithë pjesëtarët e grupeve etnike minoritare.*